

Merkantilizmi, Smithi dhe përparësitë absolute

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Hyrje

- Teoritë e Tregtisë Ndërkombëtare (TTN);
- Merkantilistët;
- Teoria e Përparësive Absolute dhe Adam Smithi;

TTN në kontekst historik

- Merkantilizmi (shek. 17 & 18)
- Adam Smith: Teoria e Përparësive Absolute (1776);
- David Ricardo: Teoria e Përparësive Komparative (1817);
- Teoria Heckscher-Ohlin (fillim i shek XX.);
- Teoria e bazuar në Ciklin Jetësor të Produktit (1966);
- Teoria e Re e Tregtisë ('70 dhe '80);
- Michael Porter: Teoria e Përparësive Konkurruese Nacionale (fillim të '90).

TTN - Konteksti

- Çështjet kyçe që do të hulumtojmë:
 1. Cila është baza për tregti/këmbim?
 - Forcat/mekanizmat të cilat i nxisin vendet të këmbejnë në mes veti. Këto janë përparësitë absolute sipas Smithit, ndërsa sipas Rikardos janë përparësitë krahasuese;
 2. Cilat janë përfitimet nga tregtia/këmbimet?
 - Rritja e konsumit në vendet që këmbejnë si rezultat i specializimit në prodhim dhe tregti;
 3. Cila është struktura e tregtisë/këmbimeve?
 - Produktet/shërbimet që importohen dhe eksportohen (struktura e këmbimeve).

TTN - Merkantilizmi

- Merkantilizëm si filozofi ekonomike: shekulli i XVII dhe XVIII;
- Merkantilist – tregtarë, bankerë, zyrtarë qeveritar, filozof);
- **Merkantilizmi:** një vend bëhet i pasur dhe i fuqishëm nëse eksporton më tepër se sa që importon;;
- Teprica do të shndërrohej në metale të çmuara: ari dhe argjent;
 - Pasuria e vendit përllogaritej në bazë të sasisë së metaleve të çmuara që ai vend posedon.
- Qeveria të bëjë çfarë është e mundur të stimuloj eksportin dhe të kufizoj importin.
 - Merkantilistët kanë predikuar nacionalizmin;

TTN - Merkantilizmi

Merkantilizmi dikur?

- Duke inkurajuar eksportin dhe kufizuar importin, qeveritë stimulonin zhvillimin e industrive të reja, rritjen e outputit, dhe gjenerimin e punësimit;

Merkantilizmi sot?

...shëndosh e mirë edhe në shekullin 21

- Vendet e industrializuara kufizojnë prodhimet bujqësore, tekstilin, këpucët, etj. për të mbrojtur punësimin në vend;
- Vendet në zhvillim janë edhe më tepër proteksioniste.

Teoria e Përparësive Absolute

- Përse vendet këmbejnë?
 - Një shpjegim për këtë është dhënë nga Adam Smithi në Teorinë e Përparësive Absolute;
- Adam Smith (*Wealth of Nations*, 1776):
- Nëse një vend ka përparësi absolute në prodhimin e një produkti, kjo do të thotë se ky vend është prodhuesi më eficient i atij produkti;
 - Nëse të gjitha vendet shrytëzojnë të njëjtat inpute në procesin e prodhimit, atëherë ky vend është në gjendje të prodhojë produkte më shumë, me kualitet më të lartë se sa të gjitha vendet tjera.

Teoria e Përparësive Absolute

- Imagjinoni botën e përbërë vetëm nga dy vende: Kina dhe Japonia;
- Të dyja vendet kanë aftësi të ndryshme për të prodhuar dy produkte të ndryshme: oriz dhe DVD;
- Për një periudhë të caktuar, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e tyre prodhojnë sasi të si në vijim:

	Kina	Japonia
Thasë orizi (ditë)	60	20
DVD (ditë)	10	75

Teoria e Përparësive Absolute

- A ka kuptim që Kina të prodhojë DVD?

JO!

- Japonia është shumë më efiçiente për prodhimin e DVD-ve, ndërsa Kina është më efiçiente në prodhimin e orizit;
- Mirëpo, të dyja këto vende kanë nevojë për të dyja produktet, andaj ka kuptim që Kina të këmbejë orizin e saj me DVD-të e Japonisë, dhe anasjelltas;

Teoria e Përparësisë Absolute

- **Parimi i Përparësisë Absolute:** Nëse secili vend koncentrohet në prodhimin e asaj që e bën më së miri, dhe specializohen në prodhimin e këtyre të mirave, atëherë këto vende mund të këmbejnë në mes veti dhe do të përfundonin me më shumë të të dyja produkteve se nëse do t'i prodhonin vet;
 - Pasi që bota i shrytëzon resurset në mënyrë eficiente, si rezultat i specializimit, shënohet rritje në konsumin dhe prodhimin e përgjithshëm;
- Konsumatorët në të dyja vendet përfitojnë pasi që do të blejnë produkte të prodhuara nga prodhuesi më eficient;

Teoria e Përparësive Absolute

- Përse kjo konsiderohet shumë e rëndësishme në lëndën e ekonomiksit?
 - *Objekt i studimit të ekonomiksit është plotësimi i nevojave dhe kërkesave të pafundme të konsumatorëve!*
- Si mund t'i plotësojmë kërkesat dhe nevojat tona të pakufizuara kur burimet i kemi kufizuara?
 - Në nuk guxojmë t'ia lejojmë vetes të hargjojmë burimet e kufizuara përmes prodhimit joefiçient.

Rikardo dhe Teoria e Përparësive Krahasuese

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Hyrje

- Smith – limitet e teorisë së tij;
- Teoria e Përparësive Krahasuese dhe David Rikardo;

TTN – Konteksti i TPK-së

- Çështjet kyçe që do të hulumtojmë:
 1. Cila është baza për tregti/këmbim?
 - Forcat/mekanizmat të cilat i nxisin vendet të këmbejnë në mes veti. Këto janë përparësitë absolute sipas Smithit, ndërsa sipas Rikardos janë përparësitë krahasuese;
 2. Cilat janë përfitimet nga tregtia/këmbimet?
 - Rritja e konsumit në vendet që këmbejnë si rezultat i specializimit në prodhim dhe tregti;
 3. Cila është struktura e tregtisë/këmbimeve?
 - Produktet/shërbimet që importohen dhe eksportohen (struktura e këmbimeve).

Teoria e Përparësive Absolute

- Imagjinoni botën e përbërë vetëm nga dy vende: Kina dhe Japonia;
- Të dyja vendet kanë aftësi të ndryshme për të prodhuar dy produkte të ndryshme: oriz dhe DVD;
- Për një periudhë të caktuar, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e tyre prodhojnë sasi të si në vijim:

	Kina	Japonia
Thasë orizi (ditë)	60	20
DVD (ditë)	10	75

Teoria e Përparësive Absolute

- A ka kuptim që Kina të prodhojë DVD?

JO!

- Japonia është shumë më efiçiente për prodhimin e DVD-ve, ndërsa Kina është më efiçiente në prodhimin e orizit;
- Mirëpo, të dyja këto vende kanë nevojë për të dyja produktet, andaj ka kuptim që Kina të këmbëjë orizin e saj me DVD-të e Japonisë, dhe anasjelltas;

Smithi - limitimet

- Kjo teori nuk tregon se çfarë do të ndodhë me vendin i cili ka përparësi absolute në prodhimin e të dy produkteve;
 - Ky vend nuk do të përfitonte nga tregtia e jashtme;
 - Teoria e Përparësive Komparative e Rikardos dhe ajo Heckscher-Ohlin janë në të njëjtën vijë me Smithin dhe sqarojnë dilemen e shtruar më parë;
- Përqindje e vogël e këmbimeve përshkruhet sipas kësaj teorie.

Teoria e Përparësive Krahasuese - TPK

- Përkundër Smithit, Rikardo e vendos theksin në dallimet krahasuese (relative) të shpenzimeve;
- Sipas kësaj teorie, edhe nëse një vend ka disavantazh absolut në prodhimin e të dyja të mirave, dhe më tutje ka hapësirë për tregti me përfitime të dyanshme;
- Vendi më pak eficient duhet të specializohet dhe të eksportojë produktin në të cilin është krahasimisht më pak joeficient (ku disavantazhi absolut është më i vogël);
 - E kundërta vlen për vendin me përparësi absolute në të dyja produktet.

Ligji i Përparësive Krahasuese

- Rikardo - *Principles of Political Economy* (1817);
 - Edhe nëse një vend është më pak eficient se (ose ka disavantazh absolut krahasuar me) një vend tjetër në prodhimin e të dyja të mirave (produkteve), edhe më tutje ekziston baza për tregti/këmbim me përfitime të dyanshme. Vendi i parë duhet të specializohe në prodhimin dhe eksportimin e produktit në të cilin ka disavantazh absolut më të vogël (në këtë të mirë vendi ka përparësi krahasuese) dhe të importojë të mirën në të cilën disavantazhi absolut është më i madh (në këtë të mirë vendi ka disavantazh krahasues);
 - Është një ndër ligjet më të qëndrueshme dhe më pak të kontestuar në ekonomi.

TPK 1

- Shembull:

	Kina	Japonia
Thasë orizi	50	14
DVD	10	7

- Bazuar në tabelë, Kina ka përparësi absolute në të dyja produktet;
 - Kina mund të prodhojnë në mënyrë më eficiente të dyja produktet se Japonia;
- Në këtë rast, a ka ndonjë arsye që këto vende të këmbejnë me njëra tjetrën?

Smithi: NUK KA DHËNË PËRGJIGJJE

Rikardo: PO

TPK 2

- Logjikimi i Rikardos:
 - Së pari, secili vend duhet të vendosë se si do t'i alokoj burimet e veta të kufizuara;
 - Nëse Kina i zhvendos në tërësi burimet në prodhimin e DVD-ve, ajo do të jetë në gjendje të prodhojë 10 DVD mirëpo do t'i duhet të heq dorë nga prodhimi i grurit;
 - Një mënyrë për t'ia lehtësuar Kinës vendimin e alokimit të burimeve, është nëse llogarisim shpenzimet për një DVD;
 - Krahasimisht, nga çfarë sasi e grurit Kina duhet të heq dorë për të prodhuar një DVD?

TPK 3

- Shpenzimet për njësi të prodhimit të DVD-ve në Kinë:

$$\frac{\text{Thasë orizi}}{\text{DVD}} = \frac{50}{10} = 5$$

- Pra, për çdo DVD që e prodhon Kina, ajo mund t'i ketë prodhuar 5 thasë oriz;
 - Çdo DVD e prodhuar i kushton Kinës 5 thasë oriz;

- Shpenzimet për njësi të DVD-ve në Japoni:

$$\frac{\text{Thasë orizi}}{\text{DVD}} = \frac{14}{7} = 2$$

- Për çdo DVD të prodhuar, Japonia heq dorë nga 2 thasë oriz.

TPK 4

- DVD-të kushtojnë më tepër në Kinë, bazuar në atë se sa duhet të sakrifikojnë oriz, se sa që kushton në Japoni;
 - Me fjalë të tjera, është më pak e kushtueshme për të prodhuar DVD-të në Japoni, andaj Kina duhet të prodhoj oriz.

Modeli i Rikardos - hipotezat

- Rikardo e bazoi TPK-në në supozimet si në vijim:
 1. Vetëm 2 vende dhe 2 të mira;
 2. Tregti e lirë;
 3. Mobilitet perfekt brenda vendit mirëpo jomobilitet në mes të vendeve;
 4. Prodhim me kosto konstante;
 5. Pa shpenzime të transportit;
 6. Pa ndryshime në teknologji;
 7. Vlera e bazuar në teorinë e punës;

Modeli i Rikardos – hipotezat 1

- Supozimi i fundit defektuoz;
 1. Sepse, presupozon ose se puna është faktori i vetëm i prodhimit, ose puna është shfrytëzuar në proporcione fikse në prodhimin e e secilës së mirë;
 2. Puna është homogjene;
 - Të dyja supozimet janë të pasakta.

TPK dhe kostot oportune

- Haberler (1936) e vendosi TPK-në kontekst të kostove oportune;
 - Ligji i Përparësive Krahasuese shpesh shihet si Ligji i Kostove Krahasuese;
 - Ligji në kontekst të kostove oportune mund të ‘përkthehet’ si në vijim:
 - Sipas teorisë së kostove oportune, kostoja e të mirës së parë është e barabartë me shumën e të mirës së dytë nga e cila duhet të hiqet dorë për të pasur në dispozicion resurse të mjaftueshme për të prodhuar një njësi shtesë të së mirës së parë;
 - Sipas këtij definicioni, vendi me kosto oportune më të ultë në prodhimin e një të mirë ka edhe përparësi krahasuese në atë të mirë (dhe disavantazh krahasues në të mirën tjetër);


TPK dhe kostot oportune 1

- Kostot oportune dhe TPK mund të ilustrohen përmes kufirit të mundësive prodhuese (KMP) si dhe të ashtuquajturës lakore e transformimit;
 - KMP paraqet lakoren e cila ilustron kombinimit e mundshme të dy të mirave të cilat mund t'i prodhojë një vend duke shfrytëzuar në tërësi resurset e saj me nivelin ekzistent të teknologjisë
 - Shembull:


SHBA		UK	
Gruri	Pëlhura	Gruri	Pëlhura
180	0	60	0
150	20	50	20
120	40	40	40
90	60	30	60
60	80	20	80
30	100	10	100
0	120	0	120

TPK dhe kostot oportune – shembulli grafikisht

SHBA



UK



TPK dhe kostot oportune – shembulli grafikisht 1

- Grafikonët më lart paraqesin kombinimet përkatëse të prodhimit të grurit dhe të pëlhurës;
 - Njësitë: gruri në milion thasë në vit, ndërsa pëlhura në milion metra në vit;
 - Pikat mbi dhe nën lakore janë pika joefiçiente;
- Vija e drejtë e KMP-së tregon se kostot oportune janë konstante, të cilat shfaqen:
 - Resurset apo faktorët e prodhimit ose janë zëvendësues perfekt, ose shfrytëzohen në proporcione fikse në prodhimin e të dy të mirave;
 - Të gjitha njësitë e të njëjtit faktor janë homogjene apo ekzaktësisht të të njëjtit kualitet;
- Shpenzimet konstante nuk kanë të bëjnë me realitetin (shih kapitullin në vijim).

TPK dhe kostot oportune – shembulli grafikisht 2

- Pjerrtësia e KMP përcaktohet si raport në mes vlerave të skajshme të prodhimit të grurit dhe të pëlhurës;
 - Pjerrtësia është e barabartë me raportin në mes të produkteve marginale të të dyja të mirave;
 - Pjerrtësia gjithashtu paraqet koston oportune të grurit, pra masën e pëlhurës që duhet sakrifikuar për të prodhuar një njësi (thes) shtesë gruri;
 - Pjerrtësia e KPM-së paraqet koston oportune të produktit në boshtin horizontal, pra grurit në rastin tonë.


TPK dhe kostot oportune – shembulli grafikisht 3

- Përparësitë krahasuese – një vend ka përparësi krahasuese në prodhimin e një të mire kostoja oportune në prodhimin të së cilës është më e vogël se sa në vendin tjetër;
 - Gruri:
 - Pjerrtësia: $SHBA_G = 120/180$ (apo $20/30$) = $2/3 = 0.67$
 - Kostoja oportune për një njësi të grurit është: $1G = 2/3P$, dhe mbetet konstante;
 - Pjerrtësia: $UK_G = 120/60$ (apo $20/10$) = 2 ;
 - Kostoja oportune për një njësi të grurit është: $1G = 2P$ dhe mbetet konstante;
 - Koment: SHBA-të kanë përparësi krahasuese në grurë pasi që kostoja oportune është më e vogël se sa për UK;

TPK dhe kostot oportune – shembulli grafikisht 4

- Përparësitë krahasuese (*vazh.*):
 - Pëlhura:
 - $SHBA_p = 180/120 = 3/2 = 1.5$;
 - Kostoja oportune për një njësi të pëlhurës është: $1P = 1.5G$, dhe mbetet konstante;
 - $UK_G = 60/120 = 0.5$;
 - Kostoja oportune për një njësi të pëlhurës është: $1P = 0.5G$, dhe mbetet konstante;
 - Koment: UK-ja ka përparësi krahasuese në pëlhurë pasi që kostoja oportune është më e vogël se sa për SHBA-të;

Baza dhe përfitimet nga shkëmbimet në kushte të shpenzimeve konstante



Baza dhe përfitimet nga shkëmbimet në kushte të shpenzimeve konstante 2

- Kur nuk këmbejnë në mes veti, psh. SHBA-të zgjedhin pikën A (90G dhe 60P) ndërsa UK zgjedhin pikën A' (40G dhe 40P);
 - Në rastin e autarkisë, KMP paraqet edhe kufirin e konsumit;
- Kur fillojnë tregtinë, SHBA-të do të specializoheshin në prodhimin e grurit (aty ku kanë përparësi krahasuese) dhe do të prodhonin në pikën B (180G dhe 0P);
- Në anën tjetër, UK-të do të specializohej në prodhimin e pëlhurës (aty ku kanë përparësi krahasuese) dhe do të prodhonin në pikën B' (0G dhe 120P);

Baza dhe përfitimet nga shkëmbimet në kushte të shpenzimet konstante 3

- Nëse këto dy vende shkëmbejnë 70G për 70P, ato do të konsumojnë në pikën E dhe E';
 - SHBA E (110G dhe 70C);
 - UK E' (70G dhe 50C).
- Tregtia ka ndikuar që këto vende të konsumojnë mbi KMP;
 - Konsumi mbi KMP ka rezultuar nga specializimi i të dyja vendeve në të mirat në të cilat kanë përparësi krahasuese;
 - Përfitimet nga tregtia:

	Para specializimit		Pas specializimit		Fitimi/humbja	
	Gruri	Pëlhura	Gruri	Pëlhura	Gruri	Pëlhura
SHBA	90	60	108	0	90	-60
UK	40	40	0	120	-40	80
Bota	130	100	180	120	50	20

Teoria standarde e tregtisë ndërkombëtare

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Hyrje

- Modeli i Rikardos i përfaqësuar me realitetin;
 - Kosto oportune në rritje;
 - Shijet dhe preferencat e konsumatorëve;
- Kufiri i Mundësive Prodhuese me kosto oportune në rritje;
- Kurbat/lakoret komunitare të indiferencës;
- Ekuilibri në autarki/izolim dhe baza si dhe përfitimet nga tregtia me kosto në rritje;

Modeli standard i tregtisë ndërkombëtare

- **Oferta:** Kufiri i Mundësive të Prodhimit me kosto në rritje;
 - Deri më tani kemi diskutuar vetëm dimensionet e ofertës mirëpo në kontekst të kostove konstante;
- **Kërkesa:** Shijet dhe preferencat e konsumatorëve;
 - Prezentohen përmes lakoreve komunitare të indiferencës;



KMP në kushte të kostove në rritje

- Shpenzimet oportune në rritje tregojnë se një vend duhet të sakrifikojë vazhdimisht më tepër nga njëri produkt me qëllim që të prodhojë njësi shtesë të produktit tjetër;
 1. Resurset apo faktorët e prodhimit nuk janë homogjen;
 - Të gjitha njësitë e një faktori nuk janë identike apo të kualitetit të njëjtë;
 2. Resurset apo faktorët e prodhimit nuk shfrytëzohen në proporcione apo me intensitet të njëjtë në prodhimin e të gjitha të mirave;

KMP në kushte të kostove në rritje 2

- Figura në vijim tregon KPM-të për Vendin 1 dhe Vendin 2;
 - Të dy KPM-të janë konkave prej origjine, që tregon se të dyja ballafaqohen me shpenzime oportune në rritje në prodhimin e të dyja të mirave;
 - Për Vendin 1, për çdo 20X shtesë që prodhon duhet të sakrifikojë vazhdimisht më tepër Y;
 - Për vendin 2, për çdo 20Y shtesë që prodhon duhet të sakrifikojë vazhdimisht më tepër X;



KMP në kushte të kostove në rritje 1



Lakoret komunitare të indiferencës

- Shijet apo preferencat e konsumatorëve: dimension i kërkesës;
- Lakoret komunitare të indiferencës (LKI) tregojnë kombinimit të ndryshme të dy produkteve të cilat japin kënaqësi të njëjtë në një vend apo komunitet;
 - Sa më e lartë të jetë lakorja aq më tepër kënaqësi tregon;
 - Që të kenë kuptim ato nuk guxojnë të priten me njëra tjetrën;
 - LKI i referohet një një shpërndarje të caktuar të të ardhurave në një vend.
 - Këto lakore janë konveksë nga origjina;
 - LKI kanë pjerrtësi negative sepse sa më shumë të konsumohet X, aq më pak do të konsumojë Y për të mbajtur nivelin e njëjtë të kënaqësisë;

Ilustrimi i LKI-ve





Ilustrimi i LKI-ve 1

- Nga figura (për Vending 1):
 - Pikat A dhe N japin kënaqësi të njëjtë;
 - Pikat T dhe H japin kënaqësi më të madhe se sa pikat A dhe N;
 - Pika E paraqet kënaqësinë më të madhe;
- Norma margjinale e zëvendësimit (NMS)
 - Në kontekst të konsumit, NMS e X i referohet sasisë së Y që një vend do të sakrifikoje për një njësi shtesë të X, kështu që edhe më tutje të qëndrojë në lakoren e njëjtë komunitare të indiferencës;
 - Zvoglimi i NMS-së tregon se një vend duke rritur konsumin e X ndërsa duke zvogluar Y, aq më i vlefshëm Y bëhet në krahasim me X.

Ekuilibri në autarki/izolim

- Figura në vijim kombinon KMP-të dhe LKI-të e prezentuara në figurat e mëparshme;
- LKI I është kurba më e lartë e cila mund të arrihet nga vendi 1 përmes KMP-së së saj
- Si rrjedhojë, Vendi 1 gjindet në ekuilibër kur kur prodhon dhe konsumon në pikën A, nën kushtet kur vendi është i mbyllur (pra nuk këmben me vendet tjera);
- Ekziston vetëm një pikëprerje (apo pikë tangjente) në mes të KMP-së dhe LKI I, apo një ekuilibër.

Ekuilibri në autarki/izolim (*vazh.*)





Ekuilibri në autarki/izolim (*vazh.*)

- Çmimet relative të produkteve në ekuilibër dhe përparësitë krahasuese;
 - Çmimi relativ i produkteve në ekuilibër në kushte të autarkisë përcaktohet nga pjerrtësia e tangjentit të përbashkët të KMP-së dhe LKI-së në pikën e autarkisë së prodhimit dhe të konsumit;
 - Faktorët e ofertës (KMP-të e vendeve) dhe faktorët e kërkesës (LKI-të e vendeve) së bashku përcaktojnë çmimet relative të produkteve në ekuilibër në kushte të autarkisë

Ekuilibri në autarki/izolim (*vazh.*)

- Çmimi relativ i produktit X në Vending 1 në kushte të autarkisë është $P_A = P_X / P_Y = 1/4$, ndërsa në Vending 2 është $P_A' = P_X / P_Y = 4$;
- Çmimet relative në të dy vendet janë të ndryshme pasi që KMP-të dhe LKI-të e tyre ndryshojnë në formë dhe lokacion;
- Pasi që në kushte të izolimit, $P_A < P_A'$, Vendi 1 ka përparësi krahasuese në produktin X ndërsa Vendi 2 në produktin Y
 - Sipas Rikardos, të dyjat mund të përfitojnë nëse specializohen, Vendi 1 në X ndërsa vendi 2 në Y



Ekilibri në autarki/izolim (*vazh.*)



Baza dhe përfitimet nga tregtia në kushte të shpenzimeve në rritje

- Duke filluar nga pika A, me specializimin e Vëndit 1 në X (dhe duke rënë përgjatë KMP-së), ky i fundit ballafaqohet me shpenzime oportune në rritje (që është e dukshme përmes rritjes së pjerrtësisë së KMP-së);
- Në rastin tjetër, duke filluar nga pika A', me specializimin e Vëndit 2 në Y (dhe duke u ngritur përgjatë KMP-së), ky i fundit ballafaqohet me shpenzime oportune në rritje (që është e dukshme përmes zvoglimin e pjerrtësisë së KMP-së);
- Specializimi në prodhim vazhdon përderisa çmimet relative të produkteve në të dyja vendet barazohen.

Baza dhe përfitimet nga tregtia në kushte të shpenzimeve në rritje 1



Baza dhe përfitimet nga tregtia në kushte të shpenzimeve në rritje 2

- Çmimi i përbashkët relativ (apo pjerrtësia) kur realizohet tregtia në mes të Vëndit 1 dhe 2 do të jetë diku në mes çmimeve relative para tregtisë, apo $\frac{1}{4}$ dhe 4
 - In figurën e kaluar është $PB = PB' = 1$.
- Kur të fillojnë të këmbëjnë në mes veti, Vendi 1 lëvizë nga A në pikën B. Duke këmbyer 60X për 60Y me Vëndin 2, Vendi 1 do të konsumojë në pikën E (70X dhe 80Y), apo në LKI-në III;

Baza dhe përfitimet nga tregtia në kushte të shpenzimeve në rritje 3

- Ky është niveli më i lartë i kënaqësisë që Vendi 1 mund ta arrijë duke tregtuar me çmime relative $P_X/P_Y = 1$.
 - Kështu Vendi 1 përfiton 20X dhe 20Y krahasuar me pikën e izolimit;
- Vendi 2 lëvizë prej pikës A' në pikën B', dhe duke këmbyer 60Y për 60X përfundon gjithashtu që konsumuari në pikën E' (100X dhe 60Y).
- Vendi 2 përfiton 20X dhe 20Y nga specializimi apo tregtia.

Specializimi i pjeshëm

- Në kushte të shpenzimeve konstante, të dyja vendet specializoheshin në tërësi në produktin në të cilin kishin përparësi krahasuese;
- Në kushte të shpenzimeve në rritje, specializimi është i pjeshëm në prodhimin e dy produkteve;
 - Sipas kësaj, Vendi 1 dhe 2 specializohen deri në pikën B dhe B', respektivisht;

Specializimi i pjeshëm 1

- **Arsyeja:** Vendi 1 duke u specializuar në X vazhdimisht i rriten shpenzimet oportune në prodhimin e X . Njëjtë, edhe Vendi 2 duke prodhuar më tepër Y , shpenzimet oportune të Y rriten;
- Me specializim, çmimet relative lëvizin në drejtim të njëra tjetrës deri sa të bëhen tërësisht identike në të dyja vendet;
 - Në këtë moment, nuk i levërdis asnjërit vend të vazhdojë të prodhojë (specializohet) produktin në të cilin ka përparësi krahasuese;
 - Kjo ndodh para se vendet të specializohen në tërësi në prodhim;

Burimet e përparive krahasuese dhe përparësitë krahasuese dinamike

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Përmbajtja

- Burimet e përparësive krahasuese;
- Përparësitë krahasuese dinamike.

Teoria Heckschr-Ohlin

- Smithi dhe Rikardo nuk e thonë troç se çfarë janë burimet e përparësive krahasuese;
- Heckscher dhe Ohlin janë të parët që e definojnë së cilat janë burimet e përparësive krahasuese:
 - Zotërimi relativ i faktorëve përcakton se cilat do të jenë përparësitë krahasuese të një vendi;
 - Faktorët: puna dhe kapitali.

Teoria Heckschr-Ohlin 1

- Një vend do të eksportoj produktet për prodhimin e të cilave nevojiten sasi më të mëdha të faktorit (punë apo kapital) të cilin ky vend e zotëron më tepër;
- Dhe do ta importojë atë produkt për prodhimin e të cilit nevojitet faktori (punë apo kapital) në këtë vend është i kufizuar;
 - India me më tepër fuqi punëtore se sa kapital do të prodhoj dhe eksportoj këpucë dhe veshëmbathje (industri intensive në fuqi punëtore)
 - SHBA me teprisë të kapitalit në raport me fuqinë punëtore, do të prodhoj dhe eksportoj makineri dhe produkte kimike (industri intensive në kapital).

Burimet e tjera të përparësive krahasuese

- Diferencat në teknologji;
- Diferencat në ekonomitë e shkallës (madhësia);
 - Përshkruan këmbimet në mes të vendeve me nivel të njëjtë të produktivitetit dhe këmbimet nga industritë e njëjta;
 - P.sh. Farmaceutikët dhe automobilat;
- Dallimet në kostot e këmbimit;
 - Diferencat në vende të ndryshme sa u përket kostove të këmbimit (psh. në shpenzimet e transportit) janë burim i përparësive krahasuese dhe ndikojnë në vëllimin dhe strukturën e këmbimeve;
 - WBDB: Tregtia përtej kufirit

Përparësitë krahasuese në kohë 1

- Shumica e burimeve/faktorëve që ndikojnë në krijimin e përparësive krahasuese ndryshojnë me kohë:
 - Teknologjia;
 - Zotërimi i faktorëve të prodhimit (punës dhe kapitalit);
 - Madhësia e industrisë;

Përparësitë krahasuese në kohë 2

- Përparësitë krahasuese dinamike;

- Përparësitë krahasuese mund të krijohen përmes mobilizimit të faktorit njeri, kapitalit dhe teknologjisë;

- Dhe, përmes politikave qeveritare të cilat promovojnë mundësi të shumta për zhvillim;

- Politika industriale: strategji për ta revitalizuar, avancoj, dhe zhvilloj një industri;

- Politika industriale parasheh masat: insentiva fiskale, garancione për kredi, norma të ulta interesi, protekcionizëm, etj.

Përparësitë krahasuese në kohë 3

- Disa politika qeveritare:
 - Në lidhje me teknologjinë;
 - R&D të sponzoruar nga qeveria;
 - Mbrojtja e pronës intelektuale;
 - Incentiva për nxitje të inovacioneve;
 - Tatime dhe subvencione;
 - Forcim i legjislacionit.

Përparësitë krahasuese në kohë 4

- Disa politika qeveritare (*vazh.*):

- Në lidhje me zotërimin e resurseve (punës dhe kapitalit)

- Incentiva për kursime;
- Incentiva për investime;
- Hua qeveritare;
- Investime në infrastrukturë;

- Në lidhje me strukturën e tregut;

- Politika mbi konkurrencën.

Diskutim

“Krijimi i përparësive krahasuese kërkon që qeveria të identifikoj ‘fituesit’ dhe të inkurajoj resurset të lëvizin në drejtim të industrive me trendet potencialisht më të mëdha të rritjes”

R. J. Carbaugh (2009), *International Economics*. 12ed.,
Mason: South-Western

A pajtoheni me këtë deklaratë?

Diskutoni këtë deklaratë në kontekst të Kosovës???

Politikat tregtare dhe politikat makroekonomike

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Përmbajtja

- Politika Tregtare e Kosovës dhe ndërlidhja me Politikat Makroekonomike;
- Koncepte të ndërlidhura me sistemin tatimor;
 - Llojet e tarifave;
 - Norma efektive e mbrojtjes;
 - Zgjatja e afatit të pagesës së tarifave;
 - Efektet e tarifave në mirëqenien e një vendi të vogël.

PTK dhe politikat makroekonomike

- Politika tregtare dhe politikat e ndërlidhura me tregtinë e jashtme;

OPTK dhe politika fiskale;

- Ndikimet në të hyrat buxhetore;
- Ndikimet në shpenzimet buxhetore;

OPTK dhe politika monetare;

- Sistemi i normave të këmbimeve valutore.

Koncepte të ndërlidhura me sistemin tatimor

- Koncepti mbi tarifat:

- Tarifat mbi importet dhe tarifat mbi eksportet;

- Sipas qëllimit: tarifat mbrojtëse (vetëm në importe) dhe tarifat për gjenerimin e të hyrave (në importe dhe eksporte);

- Llojet:

- Tarifat specifike (shumë fikse e paguar për produktin e caktuar);

- Tarifat në vlerë – *ad valorem* (% në vlerën e produktit);

- Tarifat e kombinuara;

Norma efektive e mbrojtjes

- Norma nominale tarifore – aplikohet në produktet përfundimtare të cilat importohen në vend;
 - Norma efektive e mbrojtjes – merr parasysh jo vetëm normën nominale tarifore mirëpo edhe edhe çfarëdo tarife që aplikohet në produktet e ndërmjeme që përdoren për prodhimin e të njëjtit produkt final;
 - Shkallëzimi i tarifave;
 - Sa më i lartë të jetë niveli i procesimit të produktit aq më e lartë është tarifa për atë produkt;
 - Kjo ka implikime për vendet në zhvillim pasi që shtetet e zhvilluara promovojnë prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar më të lartë.

Llogaritja e normës efektive e mbrojtjes

$$e = \frac{(n - ab)}{1 - a}$$

e – norma efektive e mbrojtjes;

n – norma nominale tarifore në produktin përfundimtar;



a – raporti i vlerës së inputeve të përfunduara me vlerën e produktit përfundimtar

b - norma nominale tarifore në inputin e importuar;


Efektet e tarifave në mirëqenien e një vendi të vogël (1)

TK paraqet diferencën në mes të sasisë së produktit që konsumatorët janë të gatshëm ta blejnë me sasisë që faktikisht e blejnë në treg.

TP janë të hyrat të cilat prodhuesit i gjenerojnë mbi sasinë minimale e cila është e nevojshme që prodhuesit ta prodhojnë produktin.



Efektet e tarifave në mirëqenien e një vendi të vogël (2)



Politika tregtare, liberalizimi, dhe instrumentet jotarifore

Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik, UP

Përmbajtja

- Liberalizimi, instrumentet jo-tarifore dhe sektori i tregtisë së jashtme;
 - Liberalizimi dhe instrumentet jo-tarifore në kontekst të Politikës Tregtare të Kosovë
- Integrimi ekonomik;
 - Liberalizimi bilateral dhe multilateral;
- Instrumentet jotarifore;
 - Kuotat;
 - Kërkesat për përmbajtje vendore të produktit;
 - Subvencionet;

PTK, liberalizimi dhe instrumentet jotarifore

- Liberalizimi;
 - Liberalizimi i mëtejshëm bilateral dhe multilateral duhet të ketë për bazë objektivat zhvillimore të Kosovës;
- Mekanizmat jo-tariforë shumë pak prezent.

Nivelet e integritimeve ekonomike (1)

- Integrimi ekonomik rajonal: marrëveshje mes vendeve në një rajon gjeografik me qëllim të zvoglimit dhe eliminimit të barrierave tarifore dhe jo-tarifore në qarkullimin e produkteve, shërbimeve, dhe faktorëve të prodhimit;
 - Nivelet e integritimit rajonal dhe më gjerë janë të ndryshme;
- Marrëveshjet për trajtim preferencial;
 - Barrierat janë më të ulta se në raport me vendet që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje;
 - Shembull: BE me Kosovën

Nivelet e integritimeve ekonomike (2)

- Marveshjet e tregtisë së lirë (FTA) – eliminon barrierat tregtare në mes të vendeve;
 - European Free Trade Association (EFTA). Sot anëtarë Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni, dhe Zvicrra.
- Union doganor – vendet heqin barrierat tregtare dhe aplikojnë politikë tregtare të përbashkët;
 - Pakti i Andeve (Bolivia, Ekuadori, Peru, dhe Kolumbia)
- Tregu i përbashkët - vendet heqin barrierat tregtare, aplikojnë politikë tregtare të përbashkët, dhe lejojnë lëvizjen e lirë të faktorëve të prodhimit;
 - Për shumë vite BE, ndërsa tani ka lëvizur në drejtim të integritimit edhe më të thellë;
 - MERCOSUR (Argjentina, Brazili, Paraguaji, dhe Uruguaji)

Nivelet e integritimeve ekonomike (3)

- Unioni ekonomik – përfshinë lëvizjen e lirë të faktorëve të prodhimit, aplikimin e politikës tregtare të përbashkët, si dhe valutën e përbashkët, harmonizimin e sistemit tatimor, dhe politikë të përbashkët monetare;
 - Bashkimi European edhe pse shume vende nuk kanë aplikuar valutën e përbashkët, si dhe sistemi tatimor mbetet i ndryshëm në vendet anëtare;
- Unioni politik;
 - BE-ja pjesërisht;
 - Parlamenti European nga 1970.


Efektet e integritimeve rajonale (1)

- Efektet statike të marrëveshjeve për liberalizim;
 - Përllogariten përmes efekteve krijuese të tregtisë dhe efekteve devijuese të këmbimeve;
 - *Efektet krijuese të tregtisë* rezultojnë kur një pjesë e prodhimitarisë vendore të vendit pjesëmarrës në marrëveshje zëvendësohet me importe me kosto më të ulët nga një vend tjetër anëtar;
 - *Efektet devijuese të tregtisë* ngjajnë kur importet me kosto më të ultë nga një vend jashtë marrëveshjes zëvendësohen me importe me kosto më të lartë të një vendi brenda marrëveshjes.

Efektet e integrimiëve rajonale (2)

- Efektet dinamike janë të lidhura me normat afatgjata të rritjes ekonomike;
 - Rritja e konkurrencës;
 - Ekonomitë e shkallës si rezultat i rritjes së madhësisë së tregut;
 - Stimulimi i investimeve;
 - Shfytësim racional i resurseve.

Efektet statike të integrimit



Instrumentet e politikës tregtare [2]

- Instrumentet jo-tarifore:

Vështirësia elementare në përkufizimin e BJT është se **ato janë të definuara me atë çfarë nuk janë**. BJT janë pengesa të natyrës jo-tarifore. Madje definimi i tyre është edhe më i përgjithshëm se aq, sepse ky term përdoret për të përfshirë edhe **intervenimet në politikën tregtare siç janë subvencionet që shërbejnë për të stimuluar dhe jo për të zbrapsur tregtinë**, andaj edhe logjikisht nuk mund të konsiderohen si 'barriera' në tregti. BJT përfshijnë edhe ato politika dëmtuese të tregtisë siç janë kuotat e importit dhe kufizimet vullnetare të eksportit. **Ato përfshijnë gjithashtu një gamë të gjerë politikash potenciale**, ndoshta edhe ato që nuk janë aplikuar ende e që ndikojnë në mënyrë indirekte në çmimet dhe/ apo sasinë e këmbimit (Deardorff dhe Stern, 1997, f. 4).

Instrumentet jo-tarifore në pol. tregtare [1]

- Subvencionet;

- Format: huazime në kesh, kredi me kushte të volitshme; lirim nga tatimet, pjesëmarrja e qeverisë në kapitalin e firmës.

- Qëllimet: (1) kompanitë e vendit të jenë konkurrentë me kompanitë importuese; dhe, (2) depërtimi në tregjet e eksportit.

- Politika Tregtare Strategjike;

- Subvencionet kanal për të përfituar nga *first-mover advantage*;


Instrumentet jo-tarifore në pol. tregtare [2]

- Kuotat e importit dhe kufizimet volontere të eksportit;
 - Përzierja në mes të kuotave dhe tatimeve për importe;
- Komponenta vendore në përmbajtjen e produktit dhe kushtëzimet për miks të produkteve;
- Politikat administrative;
- Politikat anti-damping.

Kufizimet sasiore - kuotat


- Kuotat – kufizime sasiore në importe;
 - Kuotat administrohen përmes licencave për importe;
- Llojet specifike të kuotave;
 - Kuotat globale;
 - Përcaton sasinë e produktit që mund të importohet pa marrë parasysh se nga kush apo prej nga importohet;
 - Ky format i kuotave i ka defektet e veta;
 - Kuotat selektive;
 - Alokohen për vende të caktuara;
 - Edhe kjo formë i ka defektet e veta.

Efektet e kuotave në tregti dhe mirëqenie




Rritja e kërkesës dhe ndikimi i tarifave dhe kuotave në vëllimin e tregtisë

(a) Kufizimet tarifore



(b) Kufizimet përmes kuotave




Kërkesat për përmbajtje vendore të produktit

Shteti	Minimumi i përmbajtjes vendore që duhet të ketë produkti për t'u kualifikuar për zero tarifë
Argjentina	76%
Meksika	62
Brazili	60
Uruguaji	60
Vietnami	60
Venecuela	30
Kolumbia	30

Burimi: www.ita.doc.gov (2006)

Subvencionet për prodhuesit vendor



Subvencionet për eksportues

